



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:220185
Datë: 21.07.2023
Numri i dokumentit: 04511031

Ac.nr.4532/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Ardian Ajvazi - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore Taulant Berisha nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Bajram Azemi, nga Prishtina, rr. “Agim Ramadani”, 3, NR. 45, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqësojnë Fatlum Shala dhe Filloreta Mustafa, me objekt të padisë kompensimin e dëmit, duke vepruar sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.738/15, të datës 03.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më **10.07.2023**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimit “Eurosig”, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.738/15, të datës 03.02.2020, në pikën I të dispozitivit që ka të bëjë me dëmin jo material *për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor* dhe çështja gjykohej si në vijim: **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë, që paditësit Taulant Berisha nga Prishtina që në emër të dëmit jo material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, të pësuar në aksidentin e trafikut me datë 11.04.2014, t’ia paguaj shumën prej 2,000.00 Euro (dymijëeuro), me kamatë ligjore 8%, e cila do të llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë (03.02.2020), e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor përtej shumës së gjykuar sikurse në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar, refuzohet si e pathemeltë.

II. REFUZOHET pjesërisht si e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë, ndërsa pika I e dispozitivit në pjesën që ka të bëjë me aprovimin e pjesërishtëm të kërkesëpadisë së paditësit Taulant Berisha, për kompensimin e dëmit jo material për *dhimbje fizike e frikë* dhe dëmit material *për ushqim të përforcuar, ndihmë dhe kujdes të personit të*

tretë, si dhe pika **III**, të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.738/15, të datës 03.02.2020, që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, **VËRTETOHEN**.

III. Pika **II** e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.738/15, të datës 03.02.2020 që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit, **mbetet e pashqyrtuar**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimor C.nr.738/15, të datës 03.02.2020 ka vendosur “**I. MIRATOHET Pjesërisht kërkesëpadia e paditësit Taulant Berisha nga Prishtina, ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material paditësit t’ia kompensojnë shumën e përgjithshme prej 13,800.00€, (trembëdhjetëmijetëqind euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, deri në pagimin definitiv, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit dhe atë: në emër të dëmit jo material: në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 4,000.00€, në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 3,000.00€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 6,000.00€ dhe Në emër të dëmit material: në emër të ndihmës së personit të tretë, shumën prej 500.00€, në emër të ushqim të përforcuar, shumën prej 300.00€. **II. REFUZOHET** pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi dhe atë: në emër të dëmit jo material refuzohet shuma për dhimbje fizike nga shuma 4,000.00€ gjer në 6,980.00€, për frikën e përjetuar nga shuma 4,886.00€ deri në 3,000.00€, për zvogëlimi të aktivitetit të përgjithshëm nga shuma 6,000.00€ gjer në 9,000.00€, për ndihmën e personit të tretë nga shuma 500.00€ gjer në 840.00€, për ushqim të përforcuar, nga shuma 300.00€ gjer në 840.00€, për rehabilitimit fizioterapeutik shuma prej 420.00€, e PABAZUAR. **III. DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Eurosig“, me seli në Prishtinë, që paditësit Taulant Berisha nga Prishtina, në emër të shpenzimeve procedurale të ia kompensoi shumën prej 988.80€. në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit”.**

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës material. Më këtë ankesë, e paditura konsideron se kjo ankesë është e bazuar, andaj i propozon Gjykatës së Apelit, që ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar me këtë ankesë ta ndryshoj duke i zvogëluar shumat e gjykuara.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e të paditurës është **pjesërisht e themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datë 27.03.2015, ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë, të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës

23.12.2019, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit, për aksidentin e ndodhur me datë 11.04.2014, t'ia paguajë shumat e të hollave të specifikuara si në parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë dhe atë për dëmin jo material dhe material. Si dhe ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka administruar provat dhe pas vlerësimit të tyre ka marr aktgjykimin e atakuar C.nr.738/15, të datës 03.02.2020, me të cilin pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, mes tjerash, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë sa i përket shkaktarit të aksidentit por vetëm lartësia e kërkesëpadisë. Ka shtuar se edhe përkundër faktit se ka administruar si provë Ekspertizën e Komunikacionit të datës 08.09.2014, e nxjerrë në Procedurë Penale, gjykata nuk u ndal në analizim të të njëjtës, pasi që edhe nga ajo është konstatuar përgjegjësia e të siguruarit të paditurës. Ndërsa për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga Dr. Nexhmedin Duriqi – ortoped-traumatolog dhe Dr. Samire Braina-Psikiatër, kriteret dhe përmasat për caktimin e lartësisë së dëmeve materiale dhe jo materiale të cilat i aplikojnë kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë dhe praktikën gjyqësore. Ekspertët mjekësor kanë dhënë mendimin e tyre profesional të cilët janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve të cilat janë kualifikuar si lëndime të rënda trupore që ka pësuar paditësi ka pësuar si pasojë e aksidentit të ndodhur me datën 11.04.2014. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur për pjesën aprovuese, duke ia falur besimin mendimit të ekspertëve mjekësor të cilët qartë dhe bindshëm e kanë përshkruar në tërësi natyrën dhe pasojat e lëndimeve, si dhe intensitetin e frikës që ka pësuar paditësi. Ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit e ka refuzuar pasi që ka vlerësuar se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me dëmin e pësuar dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë dhe real. Vendimin lidhur me kamatën e gjykuar, e ka mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së (*më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar*).

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pjesët në të cilat i njëjti është vërtetuar nga kjo gjykatë e shkallës së dytë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në këto pjesë, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, as në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë, *përveç pjesës së ndryshuar*, për të cilën është ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, për çka edhe ajo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, është dashur të ndryshohet.

Ndërsa, sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, Gjykata e Apelit i refuzon pretendimet ankimore të së paditurës, sa i përket atakimit të lartësive të shumave të kompensimit, të caktuara nga gjykata e shkallës së parë, për format e dëmit, si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike dhe për frikë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të

vërtetohen shumat e gjykuara nga shaklla e parë për kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, në mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183 par. 2 të LMD-së, i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë për shtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfacion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Ndërsa, sa u përket shumave të kompensimit në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes të huaj, të cilat po ashtu janë vërtetuar nga kjo gjykatë, Gjykata e Apelit konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e Gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe për ndihme e kujdes nga personi i tretë, për kohën e cekur në ekspertizë, atëherë vërtetohet se të dëmtuarit i takon e drejta në kompensim për këto forma të dëmit.

Sa i përket ankesës së palës së paditur lidhur me shumën e kompensimit për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, Gjykata e Apelit e aprovoi atë, pjesërisht si të bazuar. Në këtë pikë, Gjykata e Apelit i ndryshoi shumën e kompensimit të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, në emër të dëmit jo material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor pasi shuma e vendosur lidhur me këtë formë të dëmit, është vlerësuar si shumë e lartë, për të përmbushur qëllimin e satisfacionit material të palës së dëmtuar. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, nuk është mbështetur siç duhet në nenin 183 parag.2 të LMD-së së aplikueshëm në kohën e ndodhjes së aksidentit. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfacion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Marrë këtë parasysh, Gjykata e Apelit i vendosi shumat e kompensimit për këto forma të dëmit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në kriteret e zbatueshme për vlerësim, si dhe në praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykatat e Kosovës, (*përkatësisht Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 41/2023, të datës 27.02.2023*), për këtë formë të shpërblimit të dëmit. Duke u mbështetur në nenin 183 të LMD-së, shuma e gjykuar tani, përfaqëson një satisfacion adekuat që pala e dëmtuar t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse kjo formë e dëmit, nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen realisht me para, por të paktën, mund të bëhet kompensimi i ligjshëm i tyre (*nga fakti se referuar ekspertizës mjekësore përkatëse rezulton se paditësi ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 6 %*). Për këtë arsye, është refuzuar si e pathemeltë edhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, nga shuma e gjykuar në emër

të dëmit jo material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, e deri tek shuma e kërkuar për të sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me shpenzimet procedurale, andaj refuzohen si të paqëndrueshme edhe pretendimet ankimore kundrejt këtij vendimi, pasi që i njëjti është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykatës së Apelit i rezulton si i drejtë vendimi i gjykatës së shkallës së parë edhe lidhur me vendosjen lidhur me kamatën vjetore prej 8 % nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë bazuar në nenin 382 par.2 të LMD-së i cili shprehimisht përcakton *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që ka rezultuar se nuk ka pasur pretendime ankimore në raport me vendosjen e gjykatës së shkallës së parë në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit, andaj edhe kjo pjesë e aktgjykimit ka mbetur e pashqyrtuar, konform dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë, në pjesët e vërtetuara të aktgjykimit të atakuar, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, përveç pjesës së ndryshuar. Andaj, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195, pikat d) dhe e), lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4532/21, datë 10.07.2023

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka